



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
MINISTRIA E DREJTËSISË  
DHOMA KOMBËTARE E PËRMBARUESVE PRIVAT  
ZYRA E PËRMBARIMIT PRIVAT  
"STRATI" Sh.p.k.




Adresa: Rr."Jordan Misja", P 141/1, Shk 1, Ap 7, Tiranë, Tel: 04 45 00 450, [www.stratibailiff.com](http://www.stratibailiff.com), [info@stratibailiff.com](mailto:info@stratibailiff.com)  
Cel: Gentian Strati: 0674000450; Valter Kaçupi: 0674000456; Kozeta Guri: 0674000455

Nr. 5449

Nr. 502 Prot.

Tiranë, më 02.03.2023

Drejtuar : Qëndrës Kombëtare të Biznesit



Për dijëni : Shoqërisë "Johaniteri" Sh.p.k., (Subjekti OSHMA "MCN TV")

Autoritetit të Mediave Audiovizive

Lënda : *Urdhër për vendosjen e sekuestros konservative*

Në Tiranë, sot më datë 02.03.2023,

Unë **Valter Kaçupi**, përmbarues gjyqësor privat pranë Zyrës së Përmbarimit Privat "Strati" Sh.p.k., me NIPT L21825003E, i pajisur me çertifikatë Nr. 98, Maj 2012 lëshuar nga Ministri i Drejtësisë, pasi studiova materialet e dosjes përmbarimore, në zbatim të Urdhërit Ekzekutiv Nr. 1363 datë 17.06.2022 të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë,

**KONSTATOVA:**

Se në datë 20.02.2023, pranë Zyrës së Përmbarimit Privat "Strati" Sh.p.k., është depozituar kërkesa e palës kreditore dhe është lidhur kontrata e shërbimit për ekzekutimin e Urdhërit Ekzekutiv Nr.1363 datë 17.06.2022 të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë lëshuar për titullin ekzekutiv, Vendim me Gjobë Nr. 7, datë 08.06.2021 i Autoritetit të Mediave Audiovizive, me palë:

Kreditor : **Autoriteti i Mediave Audiovizive**

Debitor : **Shoqëria "Johaniteri" Sh.p.k., (Subjekti OSHMA "MCN TV")**

Me Objekt : *pagim gjobe*

Me Vendimin për lëshimin e Urdhërit të Ekzekutimit Nr. 1363 datë 17.06.2022 të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, është vendosur:

*"Pranimin e kërkesës së kërkuarit Autoriteti i Mediave Audiovizive.*

*Lëshimin e urdhrit të ekzekutimit për vendimin e dënimit me gjobë nr.7, datë 08.06.2021, të Grupit të Inspektimit të Drejtorisë së Mbikëqyrjes pranë AMA-s, të vendosur ndaj shoqërisë "Johaniteri" sh.p.k., me NUIS K521085011.*

*Kundër këtij vendimi nuk mund të ushtrohet ankim."*

Me shkresën Nr. 332 Prot., datë 20.02.2023 debitorit i është komunikuar lajmërimi për ekzekutimin vullnetar të detyrimit.

Sa më sipër, në kushtet kur debitori nuk ka shlyer detyrimin sipas titullit ekzekutiv, bazuar në nenin 519, 527, 593 e vijues të K.Pr.Civile, Ligjit Nr. 26/2019 datë 08.05.2019 “Për Shërbimin Përmbarimor Gjyqësor Privat” dhe Udhëzimit “Për caktimin e tarifave për shërbimet e ofruara nga shërbimi përmbarimor privat”,

### URDHËROJ:

- 1- Vendosjen e masës së sekuestros konservative në aktivet që zotëron pala debitore të regjistruara pranë jush:
  - Shoqëria “Johaniter” Sh.p.k., Subjekti OSHMA “MCN TV”, me NIPT K52108501I, me përfaqësues ligjor Zj. Marsida Karabollaj,
  - për Vendimin me Gjobë Nr. 7, datë 08.06.2021 i Autoritetit të Mediave Audiovizive.
- 2- Qendra Kombëtare e Biznesit të bëjë veprimet përkatëse duke ndaluar çdo veprim tjetërsimi apo disponimi mbi aktivet e palëve debitore.
- 3- Për veprimet apo mosveprimet tuaja, na vini në dijeni shkresërisht brenda afatit ligjor.
- 4- Personat që bëhen pengesë, do të përgjigjen sipas dispozitave të Kodit Penal dhe K.Pr.Civile.
- 5- Ky urdhër mbahet në disa kopje, dhe u njoftohet palëve të cilat kanë të drejtën e ankimit në Gjykatë brenda 5 ditëve.

**Përmbarues Gjyqësor Privat**



**Valter Kaçupi**